

VENDIM
Nr. 248, datë 20.4.202

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT NGA FONDI REZERVË I
BUXHETIT TË SHETIT PËR VITIN 2022, PËR PAGESËN E STUDIOS, PËR
ÇËSHTJEN E ANULIMIT TË VENDIMIT TË ARBITRAZHIT *ICSID CASE NO.*
*ARB/14/26***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime korente”, të programit buxhetor 01110 “Planifikim, menaxhim, administrim”, i shtohet fondi prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, për kryerjen e pagesës për detyrimet që rrjedhin ndaj studios “*Gowling*” WLG, për procesin e anulimit të vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar, datë 20.3.2020, *ICSID Case no.ARB/14/26*, ndërmjet shoqërisë “*Albaniabeg Ambient*” sh.p.k. dhe të tjerë kundër Republikës së Shqipërisë.

2. Efekti financiar prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama